

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 9 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 3 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 9 dhe neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 3 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-3632/1 datë 22.8.2025 dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, nr.ark.02-2386/2 datë 10.6.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 22-të të mbajtur më 10.6.2026 miratoi:

RREGULLORE PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES PËR MËNYRËN E SHFRYTËZIMIT, DREJTIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË AUTOMJETEVE ZYRTARE TË AGJENCISË SË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 1

Me këtë Rregullore kryhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-1063/1 datë 11.2.2015, nr.ark.01-4085/1 datë 18.6.2015, nr.ark.01-3938/1 datë 25.10.2021, nr.ark.01-4117/1 datë 25.9.2025 dhe nr.ark.01-4886/1 datë 19.11.2025 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja për automjetet zyrtare të Agjencisë).

Neni 2

Në Rregulloren për automjetet zyrtare të Agjencisë, në kapitullin I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, nëntitulli Përkufizimi i automjetit zyrtar, në nenin 2, pas fjalës: „Agjencia“ shtohen fjalët: „(ose është blerë nëpërmjet lizingu operativ (qira për hapësirë pune)“.

Neni 3

Në Rregulloren për automjetet zyrtare të Agjencisë, në kapitullin I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, nëntitulli Përkufizimi i automjetit zyrtar, në nenin 3, pas paragrafit (1), shtohet paragrafi i ri 2 i cili thotë:

„Kontrollim i automjeteve zyrtare të Agjencisë (Shtojcë nr.1) ndryshohet sipas nevojës, nga Drejtori i Agjencisë, dhe me propozimin e udhëheqësit të sektorit kompetent“.

Neni 4

Në Rregulloren për automjetet zyrtare të Agjencisë, në kapitullin III. MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE, në nenin 14, pas fjalës: „makina“, shtohen fjalët: „të cilat janë në pronësi të Agjencisë“.

Neni 5

Në Rregulloren për automjetet zyrtare të Agjencisë, në kapitullin III. MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE, nëntitulli Shlyerje/çmontimi dhe shitja e automjeteve, në nenin 19, në paragrafin (1), pas fjalës: „automjete“, shtohen fjalët: „të cilat janë në pronësi të Agjencisë“.

Neni 6

Në Rregulloren për automjetet zyrtare të Agjencisë, në kapitullin III. MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE, nëntitulli Shlyerje/çmontim dhe shitja e automjeteve, në nenin 20, kryehen plotësimet si në vijim:

- në pikën (1), pas fjalës: „automjete“, shtohen fjalët: „që janë në pronësi të Agjencisë“ dhe
- në pikën (2), pas fjalës: „automjete“, shtohen fjalët: „që janë në pronësi të Agjencisë“.

Neni 7

Në shtojcën nr.1, e cila është pjesë përbërëse e Rregullores me titull KONTROLLI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË AGJENCISË SË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE, kryhen ndryshimet dhe plotësimet e mëposhtme:

- në fillim para paragrafit (1), shtohet numri: „1“ dhe shenja e pikësimit: „.“ dhe
- pas paragrafit (1), shtohet paragrafi i ri 2. Që thotë: „2. Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nëpërmjet lizingu operativ (marrjes me qira të hapësirës) i shfrytëzon makinat zyrtare në vijim:
2.1. Skoda modeli Superb Selection dhe
2.2. Skoda modeli Superb Selection.“

Neni 8

Në dispozitat e tjera të Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit, menazhimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbetetet i pandryshuar.

Neni 9

Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**